




REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Nr. D. 2-D/DPK	Nr. Protokol 01-676/14
Nr. D. 02	Datum 25-02-2014



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

DATE/A:	25.02.2014
REFERENC-Ë:	AKK-DPKPP
PËR/ZA/TO:	znj. Sanije MALOKU Menaxhere e Zyrës së Prokurimit në Institutin Gjyqësor të Kosovës
CC:	z. Lavdim KRASNIQI Drejtor i Institutit Gjyqësor të Kosovës
NGA/OD/FROM:	z. Hasan PRETENI Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion lidhur me Tenderin me titull "Pastrimi i Objektivit"



E nderuara, znj. MALOKU ,

Duke u bazuar në nenin 5 paragrafi 1 nën paragrafi 1.12 të Ligjit për Agjencinë kundër Korrupsionit nr.03/L-159 dhe nenin 19 paragrafi 1, nën paragrafi 1.6 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, lidhur me tenderin "Pastrimi i Objektivit" me nr. prokurimi: IGJK 32214001236, Agjencia kundër Korrupsionit ofron këtë:

OPINION

Kërkohet nga ju si autoritet kontraktues (në tekstin e mëtejme A.K), që t'i ndërmerrni të gjitha veprimet e nevojshme për evitimin e shkeljeve të evidentuara në lidhje me tenderin "Pastrimi i Objektivit" në mënyrë që të respektohen dispozitat përkatëse të Ligjit nr.04 – L/042 për Prokurimin Publik.

Ar sy e t i m

Instituti Gjyqësor i Kosovës si Autoritet Kontraktues, përmes zyrës së prokurimit ka përgatitë “Njoftimin për Kontratë” me titull “Pastrimi i Objektivit” me nr. prokurimi: IGJK 32214001236, e cila është publikuar në faqen elektronike të KRPP-së me dt.11.02.2014, në Procedurën e Kuotimit të Çmimeve. Divizioni për Parandalimin e Korrupsionit në Prokurimin Publik, pranë Agjencisë Kundër Korrupsionit sipas detyrës zyrtare ka identifikuar këtë aktivitet prokurimi si rast për trajtim. Gjatë trajtimit dhe ekzaminimit të këtij aktiviteti të prokurimit në “Njoftimin për Kontratë” dhe “Dosjen e Tenderit”, Agjencia Kundër Korrupsionit ka hasur në disa të dhëna që nuk janë në pajtueshmëri të plotë me dispozitat e Ligjit në fuqi për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës.

Në “Njoftimin për Kontratë” të publikuar në faqen elektronike të KRPP-së, me datë 11.02.2014, dhe “Dosjen e Tenderit” tek rubrika III.2.3) “Kapaciteti ekonomik dhe financiar”, kërkohet nga ofertuesi të ketë pasur Qarkullim vjetor minimum **50.000,00 € (për vitet 2012-2013)**, pikë kjo e cila konsiderojmë se bie ndesh me legjislacionin në fuqi për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës.

Autoriteti Kontraktues nuk mund të kërkoj qarkullim financiar më tepër se dyfishi i vlerës së parashikuar të Kontratës, si vlerë minimale. Gjatë përcaktimit të kërkesave për kualifikim, Autoriteti Kontraktues duhet të ketë parasysh dhe ti kushtoj rëndësi të veçantë zhvillimit të Operatorëve ekonomik të rinj dhe të formuloj kërkesat minimale të kualifikimit në mënyrë që Operatorët e rinj ekonomik të cilët kanë një shkallë të kënaqshme ekonomike, teknike, të kenë mundësinë të konkurrojnë dhe të jenë pjesë e konkurrencës së lirë dhe të ndershme.

Agjencia Kundër Korrupsionit rekomandon që të vepohet në mënyrë të drejtë gjatë tërë ciklit të prokurimit pa imponuar obligime të panevojshme ose pengesa për Operatorët ekonomik të rinj të cilët ofrojnë shërbimet përkatëse. Pra, të shmanget çdo trajtim që favorizon një shërbyes të caktuar ose shërbyes potencial.

Veprimet e Autoritetit Kontraktues konsiderojmë se bien ndesh me nenin 68 Gjendja Ekonomike dhe Financiare të Ligjit për Prokurimin Publik Nr.04/L-042, nenin 8 Kriteret e Përzgjedhjes të Rregullores për Prokurimin Publik dhe, nenin 5 Gjendja ekonomike dhe Financiare e udhëzimit administrativ Nr.02/2014 të KRPP-së.

Konsiderojmë se shkelje të tilla, nuk duhet lejuar në aktivitete të prokurimit, andaj Agjencia Kundër Korrupsionit rekomandon anulimin e kësaj procedure të prokurimit dhe kërkon që të shmangen praktika të tilla në të ardhmen.

Autoritetet Kontraktuese e informojnë Agjencinë për veprimet e ndërmarra.

Me respekt !